



Informacione për prindërit – Gjermanishtja si gjuhë e dytë (DaZ)

Të dashur prindër

Gati një e treta e nxënësve në kantonin e Cyrihut flasin në familjet e tyre një gjuhë tjetër se gjermanishten. Një ndër qëllimet kryesore të shkollës fillorë është, që të gjithë fëmijët dhe të rinjtë të dinë mjaftueshëm gjermanisht për të qenë të aftë që ta ndjekin mësimin. Tek nevoja shkolla ju përkrah me mësim shtesë në gjermanishten si gjuhë të dytë (DaZ). Në vijim Ju do të gjeni informacione se si fëmijët dhe të rinjtë të cilët nuk dinë aq mirë gjermanisht përkrahen gjatë mëimit të gjermanishtes në nivelet e ndryshme të shkollës fillore.

Si i përkrah shkolla fëmijët në mësimin e gjermanishtes si gjuhë të dytë?

Kopshti i fëmijëve:

- *DaZ (gjermanishtja si gjuhë e dytë) në kopshtin për fëmijë*
Fëmijët që dinë pak ose nuk dinë fare gjermanisht marrin veçmas ose në grup, një përkrahje shtesë, nëpërmjet një mësuesi të kualifikuar për gjermanishten si gjuhë të dytë. Fëmija merr këtë përkrahje prej dy deri katër leksioneve në javë. Leksionet e gjermanishtes si gjuhë të dytë mbahen në kopshtin për fëmijë.

Cikli fillestar- dhe ai dytësor:

- *DaZ- (gjermanishtja si gjuhë e dytë) mësimi fillestar*
Fëmijët dhe të rriturit që imigrojnë në kantonin e Cyrihut, pa njohuri të gjuhës gjermane, marrin në shkollë për gjatë një viti çdo ditë „DaZ- mësim fillestar“ në një grup ose në një „klasë pranimi“. Qëllimi është që ata ti përvetësojnë sa më shpejt njohuritë thelbësore të gjuhës gjermane, që shpejt të marrin pjesë në mënyrë aktive në mësimin e një klasë të rregullt.
- *DaZ-Mësimi bazë përgatitor*
Nxënëset dhe nxënësit që tashmë i zotërojnë njohuritë bazë por akoma nuk dinë mjaftueshëm gjermanisht për ta ndjekur mësimin e rregullt, marrin normalisht dy deri katër leksione në javë „DaZ-Mësim bazë përgatitor“.

Në qoftë se një nxënëse ose një nxënës ka nevojë për përkrahje në mësimin e gjuhës gjermane, atëherë shkolla vepron me masat që vijojnë:

- Nëse mësuesit ose ju si prindër keni përshtypjen se fëmija juaj ka nevojë për përkrahje, atëherë mësuesi i klasës ju fton për një „bisedë në shkollë“ („Schulische Standortgespräch“). Atje, ju dhe mësuesi pjesëmarrës do të bini dakord se çfarë mbështetje duhet të marrë fëmija juaj. Në rast mospajtueshmërie vendos komisioni shkollor (Die Schulpflege).
- Më pas mësuesi i DaZ-it harton një plan të veçantë përkrahës për çdo fëmijë dhe e mbështet atë individualisht në mësimin e gjermanishtes.
- Mësuesi i klasës e ndihmon fëmijën në mësimin e gjermanishtes dhe kujdeset gjithashtu, që fëmija në mësim të marrë detyra që u përshtaten njohurive të tij të gjuhës gjermane.
- Mësuesit do të flasin me ju, se si ju si prind mund ta mbështetnit fëmijën tuaj në mësimin e gjermanishtes jashtë shkollës.

Çfarë mund të bëjnë prindërit?

- Tregoni fëmijës tuaj se sa e vlefshme dhe e rëndësishme është gjuha amtare si edhe gjuha gjermane.
- Ju mbështetni një zhvillim të mirë gjuhësor të fëmijës tuaj, nëse ju bisedoni shpesh me të për tema të shumëllojshme në atë gjuhë që ju e zotëroni më mirë – kjo është shpesh gjuha e juaj amtare.
- Përkrahni kontaktin me gjuhën gjermane. Fëmija juaj mëson shumë gjermanishten duke qëndruar bashkë me fëmijët gjermanofolës, në parqe lojërash, në grupe lojërash, në kopshtet me drekë për fëmijë, në strehën ditore për fëmijë në shkollë, në klube sportive, në skautizëm (Pfadi), etj.
- Merrni bashkë me fëmijën tuaj rregullisht libra për fëmijë, tregime audio, lojëra mësimi dhe mjete të tjera audiovizuale nga biblioteka e lagjes ose ajo e komunës. Shikoni më fëmijën tuaj libra me vizatime, lexojini atij libra dhe kujdesuni që ai vetë të lexojë shumë.
- Dërgojeni fëmijën në një kurs në gjuhën dhe kulturën amtare (HSK, shiko informacione të mëtejshme), nëse ka një ofertë në gjuhën tuaj amtare. Kështu fëmija mund të mësojë gjithashtu të lexojë dhe të shkruajë në gjuhën amtare. Dygjuhësia është një përparësi.
- Kujdesuni që fëmija ti bëjë detyrat e shkollës në shtëpi me orar të rregullt dhe në një vend të qetë.
- Mirëmbani një kontakt të rregullt me mësuesit e fëmijës, flisni me ata haptas për situatën e gjuhës – mësimin si dhe për mbarëvajtjen e tij në shkollë.

Informacion / konsultim

Pyetjeve në lidhje me mësimin e gjermanishtes u përgjigjet mësuesi i fëmijës ose zyra e shkollës fillore, sektori për pyetje në lidhje me mësimin, Tel.: 043 259 22 62, E-mail: unterrichtsfragen@vsa.zh.ch

Informacione më të hollësishme rreth gjermanishtes si gjuhë të dytë, mund ti gjeni në broshurën: „Deutsch als Zweitsprache in Aufnahmeunterricht und Aufnahmeklasse“ (Gjermanishtja si gjuhë e dytë në mësimin pranues dhe në klasën e pranimit) nën: www.volksschulamt.zh.ch/daz.

Informacione për kurset në gjuhën dhe kulturën amtare (HSK), si p.sh. adresat për kontaktim dhe informacionet për ofertat në 22 gjuhë të ndryshme mund ti gjeni nën: www.vsa.zh.ch/hsk dhe www.hsk-kantonzuerich.ch

Libra rekomandues për prindërit e fëmijëve që rriten me shumë gjuhë:

- Nodari C. / De Rosa R. (2003). Mehrsprachige Kinder. Ein Ratgeber für Eltern und andere Bezugspersonen. Bern: Haupt.
- Cathomas R. / Carigiet W. (2008). Top-Chance Mehrsprachigkeit. Zwei- und mehrsprachige Erziehung in Familie und Schule. Bern: Schulverlag.